

# LegalNews

Tetor 2018  
October 2018



**I. Udhëzimi Administrativ Nr.09/2018 për përcaktimin e simboleve për treguesit gjeografik, emërtimit të origjinës dhe specialitetit tradicional të garantuar.**

Ky udhëzim administrativ është publikuar më 08.10.2018 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i formës, përmbajtjes si dhe përdorimit të simboleve të treguesit gjeografik, emërtimin e origjinës dhe specialitetit tradicional të garantuar për shënjimin, promovimin dhe reklamimin e produktit nga prodhuesi, përpunuesi dhe përdoruesit e regjistruar në Agjencinë për Pronësi industriale (API).

Sipas këtij udhëzimi çdo produkt i cili ka prejardhje nga Kosova, që tregtohet në baza të emërtimit të origjinës, treguesit gjeografik, duhet të etiketohet me shenjën e përcaktuar si "Tregues Gjeografik i Mbrojtur" dhe "Emërtim i Origjinës i Mbrojtur" apo simbole që i shoqërojnë ato.

API në mënyrë elektronike u ofron simbolin apo shenjën e treguesit gjeografik, emërtimit të origjinës dhe specialitetit tradicional të garantuar, prodhuesit, përpunuesit apo përdoruesit për shënjimin dhe reklamim të produktit.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**I. The Administrative Instruction No. 09/2018 on Determining symbols for geographical indications, designation of origin and guaranteed traditional specialties.**

This Administrative Instruction has been published on 08.10.2018 in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.

The purpose of this Instruction is to regulate the form, content and the use of the symbols of geographical indications, designations of origin and guaranteed traditional specialty for labelling promoting and advertising the product by the manufacturers, processors and users that are registered with the Industrial Property Agency (IPA).

According to this Instruction every product that originates from Kosova, is marketed according to the designation of origin, geographical indication should be labelled with the indication "Protected Geographical Indication" and "Protected Designation of Origin" or with the symbols that accompany them.

The IPA shall electronically provide the symbol or indication of geographical indication, designation of origin and guaranteed traditional specialty to the manufacturer, processor or user for labelling and advertising the product.

This instruction will enter into force seven (7) days after the Minister of the Ministry of Trade and industry has signed.

## II. Ligji Nr. 06/L-090 për Ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2017, pjesa e parë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Ky ligj është publikuar më 16.10.2018, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij ligji është të ratifikoj Marrëveshjen Financiare Për IPA 2017 pjesa e parë, e lidhur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Me këtë marrëveshje Bashkimi Evropian dhe Republika e Kosovës janë pajtuar që Kosova të jetë përfutuese i IPA II (Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit).

Nën këtë program do të mbështeten sektorët si demokracia dhe qeverisja, sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore, mjedisi, veprimi klimatik dhe energjia, konkurrueshmëria, inovacioni, bujqësia dhe zhvillimi rural, si dhe arsimit, punësimi dhe politikën sociale.

Qëllimi kryesor i veprimeve nën demokracinë dhe qeverisjen është përmirësimi i kapacitetit teknik dhe administrativ i institucioneve të Kosovës.

Veprimet nën sundimin e ligjit dhe të drejtave themelore ka për qëllim rritjen e ndikimit dhe efikasitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë.

Në kuadër të mjedisit, veprimi klimatik dhe energjisë qëllimi është të kontribuoj në përdorimin efikas të energjisë në sektorin publik dhe të ndihmoj Kosovën në arritjen e kursimeve të energjisë elektrike në përputhje me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Planin e Veprimeve të Kosovës për Eficiencë të energjisë.

## II. Law No. 06/L-090 on Ratification of the financial agreement for IPA 2017, Part One, between The Republic of Kosovo and the European Union.

This Law has been published on 16.10.2018, in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.

The purpose of this law is to ratify the Financial Agreement for IPA 2017, part one between the Republic of Kosovo and the European Union.

With this agreements the European Union and the Republic of Kosovo have agreed that Kosovo shall be a IPA II beneficiary (The Instrument for Pre-accession Assistance).

Under the Action Programme for Kosovo the sectors that will be supported are: democracy and governance, rule of law and fundamental rights, environment, climate action and energy, competitiveness, innovation, agriculture and rural development and education, employment and social policies.

The main aim of the actions under democracy and governance is to strengthen technical and administrative capacity of Kosovo's institutions.

The actions under the rule of law and fundamental rights aims to increase impact and effectiveness of the Ombuds Person Institution of Kosovo.

Under the environment, climate action and energy the aim is to contribute to the efficient use of energy in public sector and to assist Kosovo in the achievement of energy savings in compliance with the requirements if the Energy Community Treaty and Kosovo's Energy Efficiency Action Plan.

Veprimet të cilat janë paraparë nën sektorin e konkurrueshmërisë, inovacionit kanë për qëllim mbështetjen e ekonomisë digjitale të Kosovës me qëllim të rritjes së konkurrencës dhe si pasojë të rezultojë në rritje dhe krijim të vendeve të reja të punës.

Nën sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural fokusohet në mbështetjen e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me saktësisht në harmonizimin dhe zbatimin e legjislacionit dhe praktikave të mira të BE-së.

Në sektorin e arsimit, punësimit dhe politikave sociale, qëllimi është të përmirësoj punësimin përmes arsimit dhe aftësimin cilësorë dhe profesional.

Kjo marrëveshje e financimit do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Komisioni pranon njoftimin nga përfituesi i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme.

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Actions that are foreseen under competitiveness, innovation subsector aim to support the digital economy in Kosovo with a purpose of enhancing the competitiveness of Kosovo's digital and traditional business, thus leading to growth and new job creation.

The action under the agriculture and rural development focuses on supporting the Kosovo Food and Veterinary Agency in aligning and implementing the EU legislation and they best practices.

In the sector of education, employment and social policies, the aim is to improve employability through quality vocational education.

This Financing Agreement shall enter into force on the date in which the Commission received a notification for the IPA II beneficiary confirming the completion of the internal procedure.

This Law shall enter into force the day of its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.

### III. Udhëzimi Administrativ Nr.11/2018 për përcaktimin e Taksave për shërbimet e ofruara nga agjencia e regjistrimit të bizneseve.

Ky Udhëzim Administrativ është publikuar më 22.10.2018 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij Udhëzimi është që të përcaktoj taksat që aplikohen për Shoqëritë Tregtare për shërbimet që ofrohen nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).

Taksat e aplikuara nga ARBK për Shoqëritë Tregtare bazohen vetëm në llojin e shërbimit të cilin e ofron ARBK, dhe jo në të ardhurat, vlerën e qarkullimit apo kapitalin e Shoqërisë Tregtare.

Pagesat e përshkruara në këtë Udhëzim Administrativ duhet të paguhet përmes llogarisë bankare, të gjitha të hyrat e realizuara nga këto taksa janë para publike dhe derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi Shtatë (7) Ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë.

### III. The Administrative Instruction No. 11/2018 on determination of fees for services provided by the Business Registration Agency.

This Administrative Instruction has been published on 22.10.2018 in the Official Gazette of the Republic of Kosova.

The purpose of this Instruction is to define the fees applied to Business Organizations for the services provided by the Kosovo Business Registration Agency (KBRA).

The fees applied by KBRA are based only on the type of service provided by the Agency and not in the revenue, turnover value or capital of the Business Organization.

The fees described in this Administrative Instruction are to be paid through bank account, all revenues generated from these fees are public money and are deposited in the budget of the Republic of Kosova.

This Administrative Instruction will enter into force seven (7) days after being signed by the Minister of Trade and Industry.

## Deloitte Contacts

### **Afrore Rudi**

Director | Tax & Legal Services  
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177  
10000 Prishtina, Republic of Kosovo  
Mob: +383 (0)49 590 807  
E-mail: [arudi@deloitteCE.com](mailto:arudi@deloitteCE.com)

### **Ardian Rexha**

Senior Legal Associate | Tax & Legal Services  
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177  
10000 Prishtina, Republic of Kosovo  
Mob: +383 (0)49 780 430  
E-mail: [arrexha@deloitteCE.com](mailto:arrexha@deloitteCE.com)

### **Vjosa Misini**

Senior Legal Associate | Tax & Legal Services  
Deloitte Kosova sh.p.k.

Str. Lidhja e Pejes, No. 177  
10000 Prishtina, Republic of Kosovo  
Mob: +383 (0)49 780 764  
E-mail: [vmisini@deloitteCE.com](mailto:vmisini@deloitteCE.com)

## **Disclaimer:**

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

\*\*\*

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see [www.deloitte.com/al/about](http://www.deloitte.com/al/about) for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 286,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.